

# Pika e juaj nismëtare në rast fatkeqësie



Me  
përdorimin e  
Kodit-QR gjeni  
pikëtakimin  
emergjent në  
komunën tuaj



# Të nderuar banorë

Ngjarjet që pëmbysin jetën tonë të përditshme janë gjithashtu edhe për ne të mundshme. Prandaj është e rëndësishme të jemi mirë të përgatitur.

Kjo broshurë tregon se ku mund të merrni informata në rast të ndonjë fatkeqësie në komunën tuaj në Kantonin Basel-Landschaft. Do të mësoni edhe se si të silleni saktë në rast të një ndërprerjeje të energjisë elektrike dhe si të përgatiteni për një dështim afatgjatë ose mungesë të energjisë. Në vazhdim në këtë broshurë do të gjeni informacione për sinjalizimin dhe furnizimet tuaja personale në rast emergjence.

Lexoni me kujdes këto informacione, printoni këtë broshurë dhe ruajeni mirë!

## Informacione të mëtejshme

I gjeni më poshtë [www.notfalltreffpunkt.bl.ch](http://www.notfalltreffpunkt.bl.ch)

Nëse keni ndonjë pyetje ose dëshirë, drejtohuni te **061 552 72 72** ose kontaktoni komunën në të cilën banoni.

### Impresum:

Kanton Basel-Landschaft, Sicherheitsdirektion  
Amt für Militär und Bevölkerungsschutz  
Oristalstrasse 100, 4410 Liestal

# Pikëtakimi emergjent, pika nismëtare e juaj në rast fatkeqësie



Nëse mjetet e zakonshme të komunikimit dështojnë dhe keni nevojë për mbështetje në rast fatkeqësie, atëherë pikëtakimi i juaj i parë emergjent është pikëtakimi më i afërt zyrtar.

Në çdo komunë në kantonin Basel-Landschaft ka të paktën një pikëtakim emergjent. Në rast se komuna juaj ku banoni goditet nga ndonjë fatkeqësi, ju do të merrni informacionet më të rëndësishme për situatën në vendngjarje në pikëtakimin emergjent. Nëse keni nevojë për ndihmë ose mund të ofroni ndihmë, pikëtakimi emergjent shërben si një vendtakim: Ku mund të bëni telefonata urgjente dhe të kërkonin ndihmë, për shembull në rast të një ndërprerje të zgjatur të energjisë elektrike kur ka dështim të telekomunikacionit.

Nepërmjet radios ose aplikacionit Alertswiss mund të kuptoni se cilat pikëtakime emergjente janë të hapura.

## Këtu mund t'i gjeni pikëtakimet emergjente

Në rast fatkeqësie, një flamur shënon vendndodhjen e pikëtakimit emergjent. Në parim, pikëtakimet emergjente janë në ndërtesa publike. Vendtakimet janë zgjedhur në atë mënyrë që të mund të arrihen nga shumica e popullsisë mbrenda një periudhe të arsyeshme kohore.

**Me rëndësi:** Në rast fatkeqësie nuk vihen demostoshmërisht në fuksion të gjitha pikëtakimet emergjente në një rajon.

Se ku ndodhet pikëtakimi i juaj emergjent më i afërt mund ta kuptoni



**PIKËTAKIMI IM EMERGJENT**



# Ndërprerja e energjisë elektrike – Si të silleni në mënyrë korrekte



Fikni të gjitha pajisjet që janë të lidhura në rrjetin elektrik. Pas rikthimit të energjisë elektrike, ndizni pajisjet njërën pas tjetrës (Rrezik nga mbingarkesa e rrjetit të energjisë elektrike).



Nëse nuk funksionon telefoni juaj: Telefononi numrin e emergjencës vetëm në raste urgjente dhe shmangni telefonatat e panovejshme (Rrezik për mbingarkesë të rrjetit). Në vend të thirrjeve telefonike, dëgjoni Radio SRF.



Fillimisht konsumoni ushqime nga frigoriferi ose nga ngrirësi dhe pastaj përdorni rezerva që nuk kanë nevojë për ftohje.




Nëse keni nevojë për ndihmë ose dëshironi të informoheni për situatën, shkoni në pikëtakimin emergjent.

**Për përgatitjen tuaj individuale për një mungesë të mundshme të energjisë elektrike-/energjisë, mund të shikoni në «Handbuch zur privaten Vorsorge» doracakun për ofrimin e masave preventive që është në dispozicionin tuaj.**



# Alarmimi në rast fatkeqësie

## Alarmi i përgjithshëm i sirenës



Në rast kanosjeje rreziku sirena tingëllon me një ton të rregullt me rritje dhe me rënie.

### Çfarë duhet bërë?

- Të dëgjoni Radio SRF
- T'i ndiqni udhëzimet e autoriteteve
- T'i informoni fqinjët dhe të afërmit

**Për raste urgjente të telefonini  
në këtë numër 112**

### Alertswiss: Platforma kombëtare e alarmit

Në rast fatkeqësie, ju do të alarmoheni dhe do të informoheni vazhdimisht nga autoritetet nëpërmjet platformës kombëtare Alertswiss. Me aplikacionin Alertswiss, juve ju vijnë alarme, paralajmërime dhe informacione si mesazhe shtytëse dirket në pajisjen tuaj celulare.

Duke përdorur kodin e më poshtëm QR mund ta shkarkoni aplikacionin në smartfonin e juaj.

 **ALERTSWISS**  
[www.alert.swiss](http://www.alert.swiss)



# Këshillë e mençur – rezerva për raste emergjente

Ai që mban rezereva në shtëpi, ka një rezervë të çmueshme në rast fatkeqësie. Kjo rezervë ju mundëson të silleni më me qetësi në një situatë të vështirë dhe ju ndihmon të mos nervozoheni ose edhe të mos keni panik. Prandaj është në interesin dhe në përgjegjësinë e secilit që të jetë në gjendje të kapërcejë një emergjencë individuale e afatshkurtër dhe të ruajë një pavarësi të caktuar për disa ditë.

## Rezervat e mia personale

### Pije

- 9 litra ujë (për person)
- Pije të tjera

- Bollgur, fruta të thata, arra
- Bishtajore
- Biskotë, galetë
- Çokollatë

### Sende ushqimore (për rreth një javë)

- Oriz dhe makarona
- Vaj dhe yndyrë
- Ushqim të konservuar (p. sh. perime, fruta ose këpurdha)
- Miell, maja e thatë
- Sallamë/suxhuk, mish të thatë
- Ushqime të gatshme, p. sh. ushqime të pjekura
- Supë të gatshme
- Djathë të fortë, djathë të përpunuar
- Bouillon, kripë, piper
- Kafe, kakao, çaj

- UHT- qumësht, qumësht të kondensuar
- Sheqer, reçel, mjaltë
- Ushqim të veçantë (në rast intolerance ushqimore)
- Ushqim për kafshët shtëpiake

### Farmaci/barnatore shtëpiake/higjienë

- Sapun, letër higjienike
- Desinfiktues
- 50 maska higjienike për person
- Medikamente personale

### Gjithçka varet nga shija

Kur të përpiloni furnizimin me rezerva për raste emergjente, merrni parasysh edhe preferencat e shijes së anëtarëve të familjes. Edhe furnizimi i caktuar me ushqim që mund të halet i ftohtë ka kuptim. Përveç të tjerash, ushqimi duhet të ruhet siç duhet, të konsumohet brenda periudhës së arsyeshme kohore dhe të zëvendësohet sërish.

### Dhe gjithashtu ...

- Radio me bateri, (manivelë-) Lampë dore me bateri, bateri rezervë
- Qirinj, kunjë shkrepsje dhe/ose çakmakë
- Tenxhere me gas, ngrohës pjate
- Ca para të gatshme